

EC

MA NDREYSHË

MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT 2021

Korrik, 2022



RAPORT

MONITORIMI I SEKTORIT TË MJEDISIT 2021

Botues: EC Ma Ndryshe Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &
Bulevardi Nënë Tereza 30B HI nr. 5, Prishtinë
www.ecmandryshe.org info@ecmandryshe.org 029 222
771 & 038 224 967

Ky dokument është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i mbështetur nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida) përmes Programit të saj "Human Rightivism" zbatuar nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit - CDF. Përmbajtja dhe pikëpamjet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtar të donatorëve.



Sweden
Sverige



Korrik, 2022

PËRMBAJTJA

01

HYRJE

02

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS

- PËR ADMINISTRATËN QËNDRORE
 - KORNIZA LIGJORE
 - DOKUMENTET E PLANIFIKIMIT, PROGRAMET, PROJEKTET DHE MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT
 - MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE RAPORTIMI MJEDISOR
 - SISTEMET E MONITORIMIT TË MJEDISIT
 - Përmbledhja e gjetjeve kryesore të raportit për gjendjen e mjedisit 2020 - AMMK
 - SISTEMET E MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE MJEDISORE
 - BASHKËPUNIMI, KOORDINIMI DHE PJESËMARRJA PUBLIKE
 - LICENCIMI DHE LEJET MJEDISORE
-

03

MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

- PËR ADMINISTRATËN QËNDRORE
 - KORNIZA LIGJORE
 - DOKUMENTET E PLANIFIKIMIT, PROGRAMET, PROJEKTET DHE MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT
 - MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE RAPORTIMI MJEDISOR
 - SISTEMET E MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE MJEDISORE
 - BASHKËPUNIMI, KOORDINIMI DHE PJESËMARRJA PUBLIKE
 - LICENCIMI DHE LEJET MJEDISORE
-

04

PËRFUNDIME

05

REKOMANDIME

Hyrje

Ky raport është një përpjekje e re e strukturuar e shoqërisë civile për të adresuar e trajtuar përgjegjësitë e organeve kompetente të Qeverisë së Kosovës karshi 8 aspekteve që rregullohen me kornizën ligjore të vendit.

Kjo metodologji merr në konsideratë 16 akte ligjore dhe nënligjore që adresojnë aspekte të ndryshme të mbrojtjes së mjedisit, si:

- Ligji nr.03/L-025 për mbrojtjen e mjedisit
- Ligji nr.03/L-233 për mbrojtjen e natyrës
- Ligji nr.03/L-160 për mbrojtjen e ajrit nga ndotja
- Ligji nr.2003_3 për pyjet e Kosovës
- Ligji nr.04/L-147 për ujërat e Kosovës
- Ligji nr.04/L-060 për mbeturina
- Ligji nr.06/L-035 për veprimtaritë hidrometeorologjike
- Ligji nr.03/L-119 për produktet biocide dhe shtojcat
- Ligji nr.02/L-53 për gjuetinë
- Ligji nr.04/L-197 për kimikate
- Ligji nr.04/L-174 për planifikimin hapësinor
- Ligji nr.04/L-175 për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit
- Ligji nr.02/L-78 për shëndetësi publike
- Rregullore (QRK) nr. 05/2017 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës të ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor
- Rregullore (QRK) nr.37/2013 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në ministrinë e bujqësisë pylltarisë dhe zhvillimit rural
- Rregullore (QRK) nr.16/2014 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës

Aspektet kryesore që ligjet e lartshënuara rregullojnë janë:

1. Organet institucionale
2. Aktet nënligjore
3. Kapacitetet njerëzore
4. Dokumentet e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor
5. Pjesëmarrja publike
6. Të dhënat mjedisore
7. Mbikëqyrja dhe raportimi
8. Licencimi dhe lejet mjedisore

Mbi këtë bazë përmbajtja e këtij raporti tenton që të mbulojë aspektet kryesore që legjislacioni në fuqi adreson. Gjetjet e këtij raporti në kapituj të caktuar kanë identifikuar mangësitë aktuale në sektorin e mjedisit, që kërkojnë vëmendje më të shtuar nga autoritetet përgjegjëse. Zyrtarët e intervistuar kanë theksuar se burimet njerëzore dhe financiare nuk janë në nivel të mjaftueshëm, gjë që mbase reflektohet edhe në gjendjen aktuale mjedisore.

Në fund janë adresuar edhe disa rekomandime me qëllim të përmirësimeve dhe plotësimeve në proceset e planifikimit dhe menaxhimit mjedisor, drejt arritjes së rezultateve më të qëndrueshme në sektorin e mjedisit dhe mbrojtjen e resurseve natyrore.

MINISTRIA E MJEDISIT, PLANIFIKIMIT HAPËSINOR DHE INFRASTRUKTURËS



PËR ADMINISTRATËN QËNDRORE

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave (MMPHI) ka raportuar se janë themeluar 4 divizione, Divizioni i Ujërave, Divizioni për Menaxhimin e Ndotjes Industriale, Divizioni për Mbeturina dhe Kimikate dhe Divizioni për Mbrojtjen e Natyrës. Numri i shërbyesve të angazhuar nuk është i mjaftueshëm në Divizionin e Mbeturinave. Qëndrimi i shprehur është se ka vëllim të madh të punëve dhe pak punonjës. Për përgatitjen profesionale të shërbyesve është dhënë vlerësimi i lartë, derisa në vitin 2021 nuk ka pasur trajnime rreth kornizës ligjore me stafin. Trajnimet ligjore për nivelin lokal nuk janë mbajtur gjatë viteve të pandemisë, vetëm në vitet paraprake. Trajnimet rreth çështjeve mjedisore gjithashtu nuk janë organizuar gjatë periudhës së pandemisë. Mbështetja për nivelin lokal në menaxhimin e çështjeve mjedisore realizohet vetëm në sja të kërkesave nga komunat. DMN-ja nuk ka zhvilluar udhëzuesit e paraparë me kornizën ligjore për vlerësime mjedisore dhe menaxhimin e çështjeve mjedisore.

Departamenti për inspektimin të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPHI) ka raportuar se nga 25 punonjësit në inspektoratin e MMPHI-së, 24 janë inspektorë dhe një zëvendës udhëheqës i Divizionit për Mjedisit, Ujëra dhe Natyrë. Ndërsa nga 24 inspektorët, 12 janë të komunitetit serb, të cilët janë angazhuar në vitin 2016 dhe me kontrata kanë të drejtën e ushtrimit të detyrës

vetëm në komunat veriore të Kosovës. Si rrjedhojë, ngelen vetëm 12 inspektorë për tërë territorin e Republikës së Kosovës, që është numër i vogël për ta mbuluar tërë kornizën ligjore në sferën e mjedisit, ujërave, natyrës, ndërtimit dhe planifikimit hapësinor. Gjithashtu është theksuar se shumica e inspektorëve kanë profilet e nevojshme, ndërsa tre nga ta janë jashtë profesionit, i cili kërkohet sipas bazës ligjore, derisa përgatitja e tyre është vlerësuar me notën 3.5, nga maksimalja që është 5. Me përkrahjen e GIZ-it janë organizuar disa trajnime rreth zbatimit të legjislatcionit mjedisorë, me theks të veçantë të shqiptimi i ndëshkimeve administrative-gjobave, procedurat gjyqësore kundërvajtëse, procedurat penale, etj. Me GIZ-in janë organizuar trajnime për inspektoratin komunal rreth përgjegjësisë ligjore të inspektorëve komunalë në sferën e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit. Ndërsa nga OSBE-ja është organizuar trajnimi rreth krimeve mjedisore. Krahas kësaj ekziston bashkëpunimi me inspektorët e nivelit lokal për çështjet mjedisore, në rastet e mbrojtjes së ajrit nga ndotja, mbrojtjen nga zhurma, trajtimin e mbeturinave, dhe njëkohësisht ka hartuar udhëzuesit sa i përket zbatimit të UA për ndëshkim me gjoba mandatore.

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit (MMPHI) ka raportuar se organet institucionale që i parasheh rregullorja përkatëse janë të themeluara. Por sipas zyrtarëve të këtij departamenti rregullorja ka kohë që nuk ka ndryshuar, derisa përgjegjësitë dhe kompetencat ligjore janë shtuar e gjendja brenda stafit ka mbetur e njëjtë. Numri i

planifikuar i shërbyesve është angazhuar në këtë departament, por megjithatë është vënë pah nevoja për angazhim të stafit shtesë për të mbuluar të gjitha përgjegjësitë e parapara. Njëkohësisht është vlerësuar se shumica e stafit kanë profilet e nevojshme për kryerjen e detyrave të përcaktuara me kornizën ligjore, bashkë me përgatitjen e duhur profesionale, që është vlerësuar me notën 4 nga maksimalja që është 5. Trajnime rreth kornizës ligjore janë organizuar për stafin, sikurse edhe për komunat sidomos pas aprovimit të legjislacionit të ri.

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore (MMPHI) nuk është përgjigjur në këtë pjesë të pyetësorit të hulumtimit.

Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit (AMMK - MMPHI) ka bërë të ditur se numri i angazhuar i shërbyesve civil për kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj nuk është i mjaftueshëm. Sipas kësaj drejtorie shërbyesit kanë profilet e nevojshme profesionale për kryerjen e detyrave dhe përgatitja e tyre profesionale është vlerësuar me notën 4 nga 5. Trajnime rreth kornizës ligjore janë organizuar me IAP, me donatorët, etj. Trajnimet janë organizuar edhe për çështje mjedisore. Ndërsa nivelit lokal i ofrohen udhëzime, sqarime e informata mbështetëse që ndërlidhen me punën e kësaj drejtorie, që kryesisht kanë të bëjnë me mbledhjen e përpunimin e të dhënave për hartimin e raporteve. Gjithashtu janë përgatitur udhëzuesit sipas temave, p.sh. për mbledhjen e të dhënave për mbeturinat.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës (AMMK-MMPHI) ka raportuar se në këtë Institut numri i shërbyesve civil nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e detyrave të përcaktuara me legjislacionin në fuqi. Në përgjigjen e ofruar thuhet se stafi ekzistues i IKMN është profesional, por i pamjaftueshëm. Sipas IKMN-së trajnimet rreth çështjeve mjedisore janë organizuar dhe ky Institut i ka ofruar mbështetje nivelit lokal rreth procedimit për marrjen nën mbrojtje të zonave të reja.

Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri" (AMMK-MMPHI) ka pohuar se trajnime rreth kornizës ligjore nuk kanë pasur, por se ka pasur diskutime për legjislacionin, dhe nga niveli qendror është kërkuar plotësimi, ndryshimi, revidimi dhe hartimi i akteve të reja ligjore e nënligjore. Ndërsa për çështjet mjedisore janë organizuar trajnime me rojtarë të natyrës për ruajtjen, mbrojtjen dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve natyrore. Me zyrtarët e 5 komunave që përfshin PK "Sharri" ka takime dhe bashkëpunim, sikurse edhe me organet ligjzbatuese, ata të drejtësisë dhe komunitetin e OJQ-të. Sipas zyrtarëve të DAPK "Sharri" në komuna të caktuara ende nuk ka gatishmëri për bashkëpunim të plotë në fushën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vlerave natyrore brenda territorit të këtij parku kombëtar. Bazuar në legjislacion DAPK "Sharri" çdo vit harton plane e projekte dhe i dërgon në MMPHI, sikurse që nxjerr edhe raporte për gjendjen brenda këtij parku kombëtar.

KORNIZA LIGJORE

Departamenti

për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave ka raportuar se korniza ligjore mjedisore është e konsoliduar, por se ka nevojë edhe për plotësim-ndryshime me qëllim të harmonizimit me direktivat e BE-së. DMMU ka theksuar se është duke u punuar për harmonizimin me legjislacionin evropian, por gjithashtu ka shtuar se zbatimi është paksa problematik, pasi gjendja në Kosovë dallon në krahasim me vendet e BE-së. Njohuritë e stafit rreth kornizës ligjore janë vlerësuar të larta.

Departamenti

për inspektimin të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor ka shprehur qëndrimin se korniza ligjore mjedisore është pjesërisht e konsoliduar, se ka mungesë harmonizimi mes ligjeve, dhe se ka ngecje në plotësim-ndryshimin e legjislacionit. Korniza ligjore rreth planifikimit dhe menaxhimit mjedisor është pjesërisht e konsoliduar, derisa punonjësit e këtij departamenti kanë njohuri mesatare sa i përket kornizës respektive ligjore, apo 3 nga nota maksimale 5.

Departamenti

i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit ka njoftuar se korniza mjedisore është pjesërisht e konsoliduar, derisa për kornizës ligjore rreth planifikimit hapësinor është thënë se është në harmoni me direktivat e BE-së. Punonjësit e këtij departamenti kanë njohuri të

mirë sa i përket kornizës respektive ligjore, apo 4 nga nota maksimale 5.

Autoriteti

Rajonal i Pellgjeve Lumore nuk është përgjigjur në këtë pjesë të pyetësorit të hulumtimit.

Drejtoria

për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit ka pohuar se korniza ligjore mjedisore ka nevojë për mirësim, dhe se ka raste të duplikimit të përgjegjësive mjedisore të institucioneve, për derisa ka edhe çështje që nuk janë rregulluar me akte nënligjore ndonëse një gjë e tillë parashihet me legjislacion. Njohuritë e stafit lidhur me kornizën respektive ligjore janë vlerësuar me notën 4 nga 5.

Instituti

i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka vlerësuar se korniza ligjore mjedisore është e konsoliduar mirë, dhe se pjesa e natyrës është e harmonizuar me legjislacionin e BE-së. Njohuritë e stafit të IKMN rreth kornizës ligjore janë vlerësuar me notën 4 nga nota maksimale 5.

Drejtoria

për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri" ka shprehur qëndrimin se korniza ligjore mjedisore është pjesërisht e konsoliduar, pasi që prej shpalljes së Parkut Kombëtar e deri më sot nuk janë sqaruar në mënyrë të saktë kompetencat ndërmjet MMPHI dhe komunave në disa çështje, si planifikimi hapësinor, inspektimi i ndërtimeve, etj.

DOKUMENTET E PLANIFIKIMIT, PROGRAMET, PROJEKTET DHE MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave ka bërë të ditur se Strategjia për Mbrojtjen e Mjedisit është në rishikim, ngjashëm si Strategjia Shtetërore për Ujëra që ka filluar të shkruhet në vitin 2021, ndërkohë që Strategjia për Menaxhimin e Mbeturinave dhe Plani përkatës është miratuar në vitin 2021. Strategjia për Menaxhimin e Kimikateve nuk është hartuar ende, e as Plani Nacional i Sigurisë nga Kimikatet. Strategjia e Veprimit për Biodiversitetin ka qenë e miratuar me afat deri në vitin 2020. Ndërkaq në proces të përpilimit janë Strategjia e Zhvillimit të Aktiviteteve Meteorologjike dhe Hidrologjike, bashkë me Strategjinë për Cilësinë e Ajrit dhe atë të Biodiversitetit, si një dokument në vete. Gjithashtu janë hartuar draft planet menaxhuese për zonat e mbrojtura PK "Sharri" dhe PK "Bjeshkët e Nemuna". Te masat e ndërmarra për mbrojtjen e vlerave natyrore në zonat e mbrojtura është raportuar për

vlerësimin e ligjshmërisë së vendimeve të komunave.

Departamenti për inspektimin të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor nuk ka ofruar përgjigje sa i përket pjesës së pyetësorit lidhur me dokumentet e planifikimit, programet, projektet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit.

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit ka pohuar se nuk ka zhvilluar hulumtime dhe vlerësime në fushën e planifikimit hapësinor dhe mjedisor dhe se nuk ka strategji në këto sektore.

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore nuk është përgjigjur në këtë pjesë të pyetësorit të hulumtimit.

Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit ka shprehur qëndrimin se nuk ka përgjegjësi në këtë kapitull. Në përgjigjet e ofruara theksohet se DVGJM/AMMK ka realizuar projekte që ndërlidhen me punën e përgjegjësitë e saj në fushën e monitorimit, vlerësimit dhe raportimit. Gjithashtu është theksuar se nuk ka përgjegjësi sa i përket marrjes së masave, pasi përgjegjësi e kësaj drejtorie është thënë të jetë vlerësimi i gjendjes së mjedisit dhe dhënia e rekomandimeve për zgjidhjen e problemeve, e të cilat rekomandime janë pjesë e raporteve të publikuara në ueb faqen e AMMK.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka shprehur qëndrimin se për nga fusha e natyrës strategjitë mjedisore janë të harmonizuara me strategjitë tjera qendrore. Te projektet janë veçuar shenjëzimi i monumenteve të natyrës, i

rezervateve, pastaj Libri i Kuq i Faunës, Libri i Kuq i Florës vaskulare, derisa te masat janë përmendur hartimi i arsyetimit profesional për zonat e reja të mbrojtura, shpallja nën mbrojtje të habitateve, për të përmendur me tej se nuk ndonjë zhvillim sa i përket masave për mbrojtjen e natyrës nga zjarret, insektet dëmtuese, sëmundjet bimore e ndotësit e ndryshëm.

Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar “Sharri” nuk është përgjigjur në këtë pjesë të pyetësorit të hulumtimit.

MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE RAPORTIMI MJEDISOR

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave ka theksuar se disa raporte hartohen e publikohen nga AMMK, derisa për Raportin për gjendjen e natyrës 2018-2021 është thënë se po hartohet.

Departamenti për inspektimin të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor ka bërë të ditur se monitorimi i zbatimit të kornizës ligjore të planifikimit dhe menaxhimit mjedisor bëhet bazuar në planin e punës si dhe inspektime ad-hoc, por edhe bazuar në kërkesa e ankesa të ndryshme. Sipas këtij departamenti raportet për inspektime janë javore, tremujore dhe vjetore. Por të dhëna tjera plotësuese nuk janë ofruar.

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit ka theksuar se në vitin 2021-2022 është hartuar Ex-Post i Ligjit për Planifikimin Hapësinor, dhe se për vitin 2022 parashihet edhe vlerësimi U.A. MMPH Nr. 08/2017 Për Normat teknike të Planifikimit Hapësinor.

Autoriteti Rajonal i Pëllgjeve Lumore nuk është përgjigjur në këtë pjesë të pyetësorit të hulumtimit.

Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit ka bërë të ditur se nuk ka përgjegjësi në zbatimin e strategjive mjedisore, dhe se bën vlerësime të përgjithshme mbi zbatimin e tyre që janë pjesë e raporteve të gjendjes së mjedisit të publikuara në ueb faqen e AMMK. Kësisoj është theksuar se në vitin 2021 është hartuar Raporti për gjendjen e mjedisit 2020, Raporti për menaxhimin e mbeturinave 2020, Raporti për gjendjen e kimikateve 2020, Vjetari për cilësinë e ajrit 2020. Sa i përket monitorimit të treguesve mjedisorë është bërë e ditur se raportet janë publike në ueb faqen e AMMK.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka raportuar se Raporti për gjendjen e natyrës është hartuar dhe publikuar për periudhën 2015-2017. IKMN gjithashtu bën monitorimin periodik për gjendjen e MNRV “Shpella e Gadimes” dhe “Ujëvarat e Mirushës” dhe rekomandon masat për përmirësimin e gjendjes. Sa i përket monitorimit të gjendjes së larmisë biologjike dhe peisazhore është thënë se mungojnë kapacitetet profesionale, por se monitorimi i faunës bëhet me kamerat kurth.

**Drejtoria për
Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri"**
nuk është përgjigjur në këtë pjesë të pyetësorit
të hulumtimit.

SISTEMET E MONITORIMIT TË MJEDISIT

**Drejtoria për
Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit** ka bërë të
ditur se të dhënat për sistemet e monitorimit
të mjedisit janë të publikuara në ueb faqen e
AMMK.

Përmbledhja e gjetjeve kryesore të raportit për gjendjen e mjedisit 2020 - AMMK

Ajri - Cilësia e ajrit në territorin e Kosovës monitorohet përmes matjeve sistematike të rrjetit të stacioneve monitoruese që menaxhohet nga AMMK/IHMK, dhe përbëhet prej 12 stacioneve statike dhe 1 stacion mobil. Të dhënat nga monitorimi flasim për tejkalime të vlerave maksimale të lejuara, për disa parametra e në veçanti për PM10 dhe PM2.5, dhe kjo kryesore gjatë sezonit të dimrit. Raportimi i të dhënave bëhet edhe përmes sistemit online të raportimit. Sa i përket trendit të koncentrimit vjetor të parametrave të monitoruar, bazuar në të dhënat vjetore për periudhën 2013-2020, vërehet një rënie e ndjeshme e koncentrimit të ndotësve që mund të ndërlihet edhe me masat që janë ndërmarrë për reduktimin e ndotjes. Procesi i identifikimit të burimeve të ndotjes i realizuar përmes inventarit të emisioneve në ajër, tregon se emetimet më të mëdha për PM10 dhe PM 2.5 vijnë nga sektori i djegieve të vogla dhe industria. Emetimet më të mëdha për NOx vijnë nga sektori i industrisë dhe transportit ndërsa emetimet më të mëdha për SO2 vijnë nga industria. Emetimet vjetore të gazrave serrë në Kosovë janë vlerësuar rreth 9613 Gg (Giga gram) CO2 eq. (equivalent) ose rreth 9.6 milion ton CO2 eq. Burimi kryesor i emetimeve të gazrave serrë është sektori i energjisë me pjesëmarrje prej 86% të totalit të emetimeve, sektori i dytë është ai i bujqësisë, pylltarisë dhe përdorimit të tokës me 8%, sektori i mbeturinave përfaqëson 5% të totalit të emisioneve kurse sektori i proceseve industriale dhe përdorimit të produkteve me rreth 1%, është konstatuar po ashtu implementimi në nivel të ulët i ligjeve, akteve nënligjore dhe i politikave për sektorin e ajrit sikurse është rasti i politikave për kontrollin e emisionet nga burimet e lëvizshme dhe atyre për kontrollin e cilësisë së naftës. Nivel i ulët i zbatimit të kërkesave ligjore është edhe në nivelin lokal edhe pse Ligji për Cilësinë e Ajrit kërkon hartimin e Planeve Lokale të Veprimit për cilësi të ajrit. Deri me tani vetëm disa komuna në Kosovë kanë hartuar e aprovuar një dokument të tillë.

Uji - Cilësia e ujërave sipërfaqësore në Kosovë, vazhdon të jetë e ndikuar nga ndotja që vjen si rezultat i shkarkimeve të ujërave urbane dhe industriale, hedhjes së pakontrolluar të mbeturinave në lumenj, përdorimit të pesticideve dhe fertilizereve në bujqësi si dhe dëmtimi i shtretërve të lumenjve nga shfrytëzimi i inerteve dhe ndërtimet ilegale. Aktualisht monitorimi i cilësisë së ujërave sipërfaqësore kryhet në 54 pika monitoruese në lumenj, ndërsa monitorimi i sasisë së ujërave kryhet në 26 stacione monitoruese. Ende nuk ka monitorim të rregullt të cilësisë së ujërave të liqeneve, dhe ujërave nëntokësore, sikurse që nuk ka as monitorim biologjik të ujërave sipërfaqësore. Treguesit e prezantuar në këtë raport tregojnë për prani të ndotësve organik në ujërat e lumenjve, megjithëse mund të konstatohet që ujërat sipërfaqësore nuk janë të rrezikuara nga eutrofikimi. Kosova ende nuk e ka të zhvilluar sistemin e trajtimit të ujërave të ndotura, meqenëse ndodhet në fazën e ndërtimit të impianteve për trajtimin e ujërave të zeza. Tashmë ka përfunduar ndërtimi i impianti për trajtimin e ujërave të zeza për regjionin e Prizrenit, ndërsa që impiantet tjera janë në fazën e studime të fisibilitetit dhe realizimit të punimeve. Aktualisht impiante funksionale për trajtimin e ujërave të ndotura janë impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në Skenderaj me kapacitet vjetor rreth 734,421 m³, si dhe 2 impiante për trajtimin e ujërave të ndotura (Harilaq dhe Badovc) me kapacitet të vogël (104,750 m³/vit).

Toka - Aktualisht Kosova, nuk ka program dhe as monitorim të rregullt të cilësisë së dheut/tokës. Ky aktivitet kryhet kryesisht përmes projekteve dhe aktiviteteve periodike. Sipas analizave të trendit të mbulshmërisë së tokave është konstatuar se ndërrimi i destinimit të tokave mbetet një nga sfidat kryesore mjedisore në sektorin e tokës. Është konstatuar se ka pasur rritje të sipërfaqeve të zonave urbane, zonave industriale e komerciale dhe atyre për nxjerrjen e mineraleve, kurse ka pasur humbje të sipërfaqeve për kategoritë e tokave bujqësore, kullotave dhe pyjeve, ndërsa që sipërfaqet e zonave të gjelbra dhe atyre rekreative kanë mbetur të njëjta. Rreth 7.35 % e sipërfaqeve të tokës në Kosovë janë identifikuar me intensitet eroziv shumë të fortë, 16.1 % të fortë, 35.4 % të mesëm, 24.55% të dobët, 10.1% shumë të dobët dhe 6.5% pa erozion. Bujqësia, konsiderohet si një nga burimet kryesore të ndotjes së tokave bujqësore, që vije si rezultat i përdorimit të plehrave kimike dhe kimikateve tjera për trajtimin e tokave. Po ashtu edhe industritë aktive dhe ato të vjetra janë burim potencial i ndotjes së tokave për shkak të gjenerimit të mbetjeve industriale dhe përdorimit të kimikateve që në disa raste ruhen në vende të pasigurta.

Zonat e mbrojtura dhe biodiversiteti - Gjatë vitit 2020, regjistri kombëtarë i zonave të mbrojtura është shtuar edhe për 7 zona të reja, duke e rritur numrin e zonave të mbrojtura në 217 zona me një sipërfaqe prej 125816.6 ha ose 11.53% e territorit të Kosovës. Përkundër rritjes së vazhdueshme të numrit të zonave të mbrojtura dhe sipërfaqes së tyre, menaxhimi i efikas i zonave të mbrojtura dhe parandalimi i veprimeve ilegale në këto zona vazhdon të mbetet problem për institucionet e Kosovës. Ka ende zona të mbrojtura që gëzojnë status të veçantë të mbrojtjes të cilat ende nuk kanë organe menaxhuese përkatëse. Problem, vlerësohet të jetë edhe mungesa e planeve hapësinore, menaxhuese dhe rregulluese për disa nga këto zona. Nga monitorimi i faunës përmes kamerave kurthe janë marrë informacione për praninë e disa llojeve të rralla dhe të rrezikuara të faunës në Kosovë. Ka mungesë të programeve të veçanta për monitorimin e biodiversitetit në përgjithësi apo llojeve të veçanta në veçanti. Konsiderohen si pozitive dhe me rëndësi zbatimi i disa iniciativave dhe projekteve për menaxhimin ndërkufitarë të zonave natyrore.

Menaxhimi i Mbeturinave - Kosova vazhdon të ballafaqohet me mungesë të menaxhimit efikas të mbeturinave. Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori është vlerësuar të 230.85kg/banorë/vit. Aktualisht në nivel nacional grumbullohet rreth 84% e mbeturinave të gjeneruara. Pjesa më e madhe e tyre deponohet në deponi sanitare, ndërsa që ende nuk ka sistem të organizuar të ndarjes në burim dhe riciklimin të mbeturinave. Menaxhimi i deponive sanitare të Kosovës, nuk është i mirë dhe ndër problemet kryesore janë mos funksionimi i sistemeve të pompimit të ujërave të deponisë, kompresimi jo i mirë i mbeturinave të deponuara dhe mbulimi jo i mjaftueshëm i mbeturinave. Është evidentuar po ashtu edhe numër i madh i deponive ilegale në tërë territorin e Kosovës edhe pse ka pasur një progres të vogël në vitin 2020 (1489 në vitin 2019, dhe 1189 në vitin 2020). Përkundër angazhimit të vazhdueshme të institucioneve qendrore, komunave dhe donatorëve, deponitë ilegale vazhdojnë të jenë sfidë e këtij sektori. Aktivitetet për ndarjen në burim, trajtimin e mbeturinave, riciklimin e mbeturinave dhe aspektet tjera që ndërlidhen me ekonominë qarkore ende janë në një shkallë të ulët. Krahasuar me vitin 2019, gjatë vitit 2020 ka pasur gjenerim më të madh të mbeturinave spitalore, që ka ardhur si rezultat në përballje me pandeminë COVID19.

Shëndeti publik- Numri i sëmundjeve ambientale të regjistruara vazhdon të ketë një trend linearë në Kosovë. Në disa raste është regjistruar një ngritje e ndjeshme e numrit të disa sëmundjeve që ndërlidhen me aspektet mjedisore. Gjatë vitit 2020, duhet të veçohet numri i madhe i të sëmurëve me COVID19. Megjithatë në Kosovë ende nuk ka një studim të detajuar dhe të bazuar në tregues, që do të vlerësonte ndikimin real të gjendjes së mjedisit në shëndetin publik. Sipas të dhënave statistikore

mbi shkaqet e vdekjeve në Kosovë konstatohet se numri më i madhe i vdekjeve, sa i përket shkaqeve që ndërlidhen me mjedisit janë ato nga sëmundjet e sistemit të qarkullimit të gjakut, tumoret dhe nga sëmundjet e sistemit të frymëmarrjes. Masha mesatare e të vdekurve në Kosovë vlerësohet të jetë 73.1 vjet. Kontroll i ujit të pijshëm tregon se rreth 99.4% e testeve kanë qenë në përputhshmëri me standardet vendore të cilësisë së ujit.

Shfrytëzimi i resurseve natyrore - Shfrytëzimi i gurit dhe resurseve tjera minerare që realizohet përmes gurëthyesve, e cila është një nga format më të shpeshta të shfrytëzimit të resurseve natyrore në Kosovë. Gjatë vitit 2020 janë lëshuar 228 licenca për shfrytëzim të gurit dhe 204 licenca për hulumtime të rezervave të gurit. Të dhënat flasin se ka edhe operatorë ilegal që merren me këtë veprimtari. Vlerësohet se gjatë vitit 2020, sipas planifikimit janë shfrytëzuar 157,970.95 m³ masë drunore nga pyjet e Kosovës, nga sektori privat dhe ai publik. Në këtë vlerësim nuk janë përfshirë prerjet ilegale të pyjeve. Kurse, sa i përket ujit, sasia më e madhe e saj shfrytëzohet për pije si dhe nga sektori i amvisërisë, sektori i industrisë dhe ai i ujitjes së tokave.

Masat e ndërmarra për përmirësimin e gjendjes së mjedisit - Kosova vazhdon angazhimin e saj në harmonizimin e legjisllacionit nacional me direktivat e BE-së, megjithëse sfida mbetet implementimi i tyre. Janë hartuar dhe aprovuar strategji dhe plane veprimi për të gjithë sektorët mjedisore, si në nivelin qendror dhe atë lokal mirë po niveli i zbatimit të tyre është i pjesshëm. Edhe pse gjatë vitit 2020 janë shtuar aktivitetet inspektuese dhe mbikëqyrëse në sektorin e mbrojtjes së natyrës, aktivitetet ilegale që degradojnë dhe dëmtojnë mjedisit janë ende në numër shqetësues. Ndonëse është rritur buxheti për projekte kapitale mjedisore, dhe gjithashtu është rritur edhe numri i projekteve nga donatorët, nevoja dhe kërkesa për investime në mjedis mbetet ende e lartë. Çështja e mjedisit në Kosovë ende trajtohet me prioritet të ulët nga Qeveria e Kosovës.

SISTEMET E MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE MJEDISORE

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave ka raportuar se Regjistri qendror i zonave të mbrojtura të natyrës dhe trashëgimisë natyrore është i zhvilluar. Por ai nuk përditësohet në mënyrë sistematike.

Departamenti për inspektimin të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor nuk ka ofruar përgjigje për këtë pjesë të hulumtimit.

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore ka pohuar se ka të ndërtuar Sistemin Informativ Ujor (2021), pastaj Regjistrin e zonave të mbrojtura ujore (2019), Regjistrin e lejeve ujore (2022), Regjistrin e objekteve dhe pajisjeve ujore në nivel pellgu; Kadastrin ujor dhe protokollin ujor (2021) e Regjistrat për zonat erozive, zonat sanitare, zonat të ndjeshme, koncesione, shpronësime.

Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit ka bërë të ditur se ka në funksion dhe përditëson Sistemin Informativ Mjedisor, Kadastrin e

Ndotësve, Sistemin Informativ Ujor, Sistemin për administrim me vlerat e natyrës dhe vlerat e mbrojtura të natyrës; Regjistrin e zonave të mbrojtura ujore; Sistemin informativ për mbrojtjen e mjedisit, përfshirë pjesën hartografike të databazës; derisa pjesërisht menaxhohen të dhënat për Inventarin e Produkteve Biocide dhe Substancave Aktive Biocide, pastaj për Listën e Produkteve Biocide të lejuara; për Regjistrin e përgjithshëm për kimikate; për Regjistrin e substancave të rrezikshme që shkaktojnë shqetësime; ndërkohë që në proces është Sistemi i Informimit për menaxhimin e mbeturinave. DVGJM ka pohuar se ka numër të kufizuar të stafit për krijimin, grumbullimin dhe menaxhimin e të dhënave mjedisore.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës ka njoftuar se pohuar se në vitin 2020 është publikuar Regjistri qendror i zonave të mbrojtura të natyrës dhe trashëgimisë natyrore; Baza e të dhënave lidhur me mbrojtjen e vlerave të biodiversitetit, llojeve të rralla, të rrezikuara, endemike, relikte, dhe mjekësore; dhe Inventarizimi i vlerave të reja të trashëgimisë natyrore.

BASHKËPUNIMI, KOORDINIMI DHE PJESËMARRJA PUBLIKE

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave ka raportuar se bashkëpunimi është i kënaqshëm

me ministritë dhe institucionet tjera publike në hartimin e akteve ligjore e nënligjore, si dhe strategjive mjedisore. Ndërsa nga organizatat e shoqërisë civile kontributi kryesisht merret gjatë procesit të diskutimit publik, derisa aktivistët në raste të caktuara përfshihen edhe në grupet punuese.

Departamenti për inspektimin të Mjedisit, Natyrës, Ujërave, Ndërtimit dhe Planifikimit Hapësinor nuk ka ofruar përgjigje për këtë pjesë të hulumtimit.

Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit ka vlerësuar se bashkëpunimi është në nivelin e duhur me institucione tjera gjatë fazës së hartimit të dokumenteve ligjore, si dhe në përfshirjen e tyre në grupe punuese, përfshirë këtu edhe komunitetin e donatorëve. Bashkëpunimi është cilësuar si mjaft i mirë edhe me nivelin lokal, përfshirë takimet e rregullta me Asociacionin e Komunave të Kosovës respektivisht Kolegjiumin për Planifikim Hapësinor. Te bashkëpunimi dhe koordinimi me OJQ-të në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore është shprehur qëndrimi se aty ku ka pasur nevojë janë konsultuar grupet e interesit përmes përfaqësimit nga shoqatat apo OJQ-të e ndryshme, dhe se bashkëpunim ka pasur edhe në promovimin e legjislacionit në fuqi me shoqata të ndryshme. Ndërkaq pjesëmarrja e publikut në këto procese është vlerësuar si mesatare.

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore nuk është përgjigjur në këtë pjesë të pyetësorit të hulumtimit.

Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit ka vlerësuar si të kënaqshëm bashkëpunimin me institucionet publike dhe OJQ-të në hartimin e akteve ligjore e nënligjore si dhe në hartimin e strategjive mjedisore. Ndërsa pjesëmarrjen e publikut në hartimin e dokumenteve mjedisore e ka vlerësuar si mesatare.

Instituti i Kosovës për Mbrojtjen e Natyrës nuk ka ofruar të dhëna rreth bashkëpunimit me institucionet tjera publike në hartimin e akteve ligjore e nënligjore, por pjesëmarrjen e publikut në proceset e tilla e ka vlerësuar si shumë të kënaqshme.

Drejtoria për Administrimin e Parkut Kombëtar "Sharri" nuk është përgjigjur në këtë pjesë të pyetësorit të hulumtimit.

veçantë të mbeturinave 9, Leje për import të mbeturinave 3, Leje për transit të mbeturinave 2, Leje për eksport të mbeturinave 44, Leje për import të qeseve plastike 14, dhe Biocide 53.

Autoriteti Rajonal i Pellgjeve Lumore ka njoftuar se në vitin 2021 janë 66 leje ujore për nxjerrje të ujit për konsum të përgjithshëm për 5 vite; pastaj 67 leje ujore për shkarkim të ujërave të ndotura për 5 vite, sikurse edhe 8 leje ujore për përdorimin e ujërave me qëllim të shfrytëzimit të energjisë elektrike dhe gjeotermale për 20 vite, dhe 8 urdhëresa ujore.

LICENCIMI DHE LEJET MJEDISORE

Departamenti për Mbrojtjen e Mjedisit dhe Ujërave ka bërë të ditur se janë lëshuar 82 pëlqime mjedisore, 6 leje të integruara mjedisore, derisa te lejet ujore për eksplotimin e rërës, zhavorrit, gurit dhe argjilit ka pasur 26 leje dhe 19 refuzime, pastaj janë regjistruar 5 leje për import të kimikateve, derisa 3 leje janë lëshuar për ndërhyrjet në zonat e mbrojtura me ligj. Ndërkaq Licenca për menaxhimin e mbeturinave të lëshuara në vitin 2021 kanë qenë 12, Autorizime mjedisore me një rast të

MINISTRIA E BUJQËSISË PYLLTARISË DHE ZHVILLIMIT RURAL



PËR ADMINISTRATËN QËNDRORE

Departamenti

i Pylltarisë (MBPZHR) ka bërë të ditur se numri i angazhuar i shërbyesve civil nuk është i mjaftueshëm për të përmbushur detyrat e departamentit, ndërkohë që vetëm dy prej të punësuarve aktual janë të profilit të duhur, ndërsa pjesa tjetër janë të profileve jo përkatëse. Përgatitja profesionale e stafit është vlerësuar me notën 3 nga 5; derisa trajnime nga ky departament rreth kornizës ligjore nuk janë organizuar. Gjithashtu ky departament nuk ka ofruar mbështetje për nivelin lokal në menaxhimin e çështjeve mjedisore, e as udhëzues përkatës.

Drejtoria

për Menaxhim me Pyje (MBPZHR) ka raportuar se numri i shërbyesve civil për kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj nuk është i mjaftueshëm, derisa stafi aktual ka profilet e nevojshme profesionale. Trajnimet për kornizën ligjore janë mbajtur nga donatorët dhe IAP, ndërkohë që vet drejtoria nuk ka organizuar ndonjë trajnim për nivelin lokal, megjithëse ka njoftuar se e mbështetë nivelin lokal lidhur me çështjet e menaxhimit të pyjeve.

Drejtoria

për Menaxhim me Kafshë të Egra, Gjueti, Kullosa dhe Eko – Turizëm (MBPZHR) ka bërë të ditur se ka të mbi punësuar tre veta nga plani apo Rregullorja nr. 16/14 për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në Agjencinë Pyjore të Kosovës, si pasojë e Vendimit dhe marrëveshjes së Brukselit

lidhur me shpërbërjen e strukturave paralele në Komunitet e Veriut të Republikës së Kosovës, ku janë sistemuar 8 persona nga struktura paralele e mbrojtjes civile në DMKEKGJET-VGJRV në Dubočak, pa përgatitje adekuate profesionale, dhe kështu janë zënë 6 pozitave profesionale të lira të punës që kishte atëherë DMKEKGJET. Numri i punonjësve është vlerësuar i pamjaftueshëm, dhe se nuk i kanë profilet e nevojshme profesionale, që është vlerësuar me notën 3 nga 5 sa është maksimalja. Trajnimet për çështje mjedisore janë organizuar lidhur me veprimtarinë e drejtorisë, derisa niveli lokal mbështetet me monitorimin e zhvillimit të aktiviteteve në vendgjuetitë e përbashkëta dhe udhëzimet për menaxherët e tyre.

KORNIZA LIGJORE

Departamenti

i Pylltarisë ka vlerësuar se korniza ligjore është pjesërisht e konsoliduar dhe pjesërisht e harmonizuar me legjisllacionin e BE-së.

Drejtoria

për Menaxhim me Pyje nuk është përgjigjur në këtë pjesë të pyetësorit të hulumtimit.

Drejtoria

për Menaxhim me Kafshë të Egra, Gjueti, Kullosa dhe Eko – Turizëm (MBPZHR) ka vlerësuar me notën 4 nga 5 njohuritë e stafit rreth kornizës përkatëse ligjore.

DOKUMENTET E PLANIFIKIMIT, PROGRAMET, PROJEKTET DHE MASAT PËR MBROJTJEN E MJEDISIT

Departamenti

i Pylltarisë ka bërë të ditur se strategjitë mjedisore nuk janë të harmonizuara mirë me strategjitë tjera qendrore. Nuk janë ofruar të dhëna rreth projekteve për mbrojtjen e mjedisit. Te masat janë përmendur plani vjetor për menaxhimin me pyje, programi për zhvillimin e fidanishtes pyjore, programi kombëtar për shëndetin e pyjeve, programi kombëtar për menaxhimin e zjarreve pyjore.

Drejtoria

për Menaxhim me Pyje ka konfirmuar se nuk ka plane menaxhuese për pyjet private. Kjo drejtori ka theksuar se plani menaxhues afatgjatë për pyjet publike është aktiv, sikurse edhe plani vjetor përkatës, dhe plani operativ vjetor dhe planet për shfrytëzimin e pyjeve. Te projektet kapitale është veçuar ai për pyllëzimet në vlerë mbi 200,000 euro, realizuar nga tetori deri në dhjetor në të tërë territorin e vendit. Kjo drejtori ka njoftuar se ka pas masa për mbrojtjen e zhvillimin e pyjeve në

saje të një memorandumit me Komunën e Gjakovës, pastaj për pyllëzimin e sipërfaqeve të zhveshura në tërë vendin, derisa masa për dëmtuesit dhe sëmundjet nuk ka pasur ndonjë po punohet në metodologjinë për hartimin e softuerit për mbrojtjen nga zjarri në pyje.

Drejtoria

për Menaxhim me Kafshë të Egra, Gjueti, Kullosa dhe Eko - Turizëm (MBPZHR) ka bërë të ditur se Strategjia Nacionale për Menaxhimin e qëndrueshëm të kafshëve të egra 2013-2023 është aktiv, sikurse Plani menaxhues i VGJRV në Blinajë, derisa Plani menaxhues i VGJRV në Duboçak ka qenë aktiv deri në vitin 2021. Ndërsa Vendgjuetitë e përbashkëta të cilat janë dhënë në menaxhim nga komunat e që deri më tani janë 20, janë të obliguara që në afat prej 6 muajsh të hartojnë planet menaxhuese 10 vjeçare si dhe Planet operacionale vjetore. Masat për mbrojtjen dhe zhvillimin e florës dhe faunës janë ndërmarrë në Blinajë e Duboçak, bashkë me kujdestaritë aktive për shuarjen e zjarreve eventuale në Blinajë e Duboçak.

MBIKËQYRJA INSPEKTIVE DHE RAPORTIMI MJEDISOR

Departamenti

i Pylltarisë ka theksuar se Bordi Pyjor Këshillëdhënës nuk është formuar. Raporti i numrit të kafshëve të marra për qëllime shkencore nuk është zbatuar për shkak të

problemeve me inspektoratin pyjor, derisa nuk ka as raport rreth planeve menaxhuese të pyjeve. Inventarizimi i pyjeve është në zbatim, sikurse edhe regjistrimi i fidanëve dhe raportimi vjetor për menaxhimin me pyje.

Drejtoria për Menaxhim me Pyje ka pohuar se Bordi Pyjor Këshillëdhënës nuk është funksional, dhe se inventarizimi kombëtar i pyjeve është në zbatim, sikurse edhe raportimi mbi prodhimin fidanor dhe pyllëzimet.

Drejtoria për Menaxhim me Kafshë të Egra, Gjueti, Kullosa dhe Eko - Turizëm (MBPZHR) ka pohuar se ekziston raporti lidhur me numrin e kafshëve të marra për qëllime shkencore, sikurse që ka raportim edhe për menaxhimin vjetor me pyje, por edhe për inventarizimin e kafshëve të egra. Kjo drejtori ka raportuar se monitorohet gjendja e larmisë biologjike e peisazhore, gjendja e zonave të mbrojtura dhe gjendja e pyjeve, dhe se në Blinajë e Duboçak nuk ka veprime ilegale në pyje. Njëkohësisht nuk janë identifikuar veprime të palejuara.

Drejtoria për Menaxhim me Pyje ka përsëritur se inventarizimi i pyjeve publike është në zbatim.

Drejtoria për Menaxhim me Kafshë të Egra, Gjueti, Kullosa dhe Eko - Turizëm (MBPZHR) ka pohuar ekzistimin e Bazës së të dhënave për llojet e bimëve, kërpudhave dhe shtazëve, tipave të vendbanimeve, ekosistemeve dhe peizazheve. Gjithashtu ka theksuar se APK është në fazën finale të implementimit të Projektit të Sistemit Informativ për Pylltarinë e Kosovës (SIPK, përkatësisht KFIS), ku është edhe moduli për gjueti. Aktualisht janë siguruar të dhëna elementare (sipërfaqja e vendgjuetisë, Menaxhuesi i VGJP, Menaxheri i kontratës nga Komuna, vlera e kontratave, etj) vetëm nga vendgjuetitë e dhëna në menaxhim. Por ka shtuar se duhet kompletuar stafin profesional (inxhinier i pyjeve me njohuri në sektorin e gjuetisë, zyrtarë për veterinarë ose zyrtar i zoologjisë) në sektorin e menaxhimit me kafshë të egra, gjueti dhe eko-turizëm.

SISTEMET E MENAXHIMIT TË TË DHËNAVE MJEDISORE

Departamenti i Pylltarisë ka theksuar se inventarizimi i pyjeve publike është në zbatim nga 2013, por se nuk ka regjistër të pyjeve private.

BASHKËPUNIMI, KOORDINIMI DHE PJESËMARRJA PUBLIKE

Departamenti i Pylltarisë ka theksuar se ka bashkëpunim me institucionet publike e shoqërinë civile për hartimin e ligjeve e akteve nënligjore, sikurse që merr pjesë edhe në grupe të ndryshme punuese. Por pjesëmarrjen e publikut e ka vlerësuar me notën 2 nga 5.

Drejtoria

për Menaxhim me Pyje nuk është përgjigjur në këtë pjesë të pyetësorit të hulumtimit.

Drejtoria

për Menaxhim me Kafshë të Egra, Gjueti, Kullosa dhe Eko - Turizëm (MBPZHR) ka theksuar se me rastin e hartimit të Planeve vjetore për menaxhim me pyje dhe faunë të egër, respektohet afati prej 30 ditëve për diskutimin publik të planeve dhe marrjen e komenteve nga publiku-palët e interesit. Pjesëmarrja e publikut në procese të tilla është vlerësuar me notën 3 nga 5.

LICENCIMI DHE LEJET MJEDISORE

Departamenti

i Pyltarisë ka theksuar se janë lëshuar 24,469 leje të transportit të drunjve, fletëpërcjellje ditore; derisa janë dhënë 4 licenca për pyllëzim, dhe 1 leje për gjah për qëllime shkencore. Licenca për prerjen e drunjve në pyjet publike në vitin 2021 janë 19 sosh, derisa 16 është numri i licencave për shfrytëzimin e produkteve pyjore jodrunore dhe 4 licenca për pyllëzime.

Drejtoria

për Menaxhim me Pyje te lejet e transportit të drunjve – fletëpërcjellëset për pyjet private ka pohuar se gjithsej janë lëshuar 24,421 të tilla vetëm për një rrugë transporti.

Drejtoria

për Menaxhim me Kafshë të Egra, Gjueti, Kullosa dhe Eko - Turizëm (MBPZHR) ka bërë të ditur se në vitin 2021 janë dhënë 1,032 leje të transportit të drunjve, 1 leje për hulumtime dhe vizita arsimore në rezervatin strikt, 29 leje për xhirim apo fotografim në rezervatin strikt, parkun kombëtar, zonën e veçantë, parkun e natyrës, peizazhin e mbrojtur, dhe në monumentin e arkitekturës; dhe 1 leje për gjah për qëllime shkencore. Ndërsa numri i licencave për shënjimimin e drunjve në pyjet publike është 927 dhe po aq është edhe numri i licencave për prerjen e drunjve në pyjet publike.

PËRFUNDIME

Pjesa dërmuese e organeve kompetente të nivelit qendror kanë theksuar se numri i angazhuar i shërbyesve civil për kryerjen e detyrave të përcaktuara me ligj nuk është i mjaftueshëm. Disa prej tyre kanë pohuar edhe nevojën për bashkëpunim më të plotë me nivelin lokal në fushën e mbrojtjes dhe ruajtjes së vlerave natyrore.

Për kornizën ligjore mjedisore është shprehur qëndrimi se është e konsoliduar, por se ka nevojë edhe për plotësim-ndryshime me qëllim të harmonizimit me legjislacionin e BE-së.

Të dhënat e grumbulluara në kuadër të hulumtimit lidhur me dokumentet e planifikimit, programet, projektet dhe masat për mbrojtjen e mjedisit janë simbolike, dhe vetvetiu është tregues për nevojën e përmirësimit të punës së organeve përgjegjëse në këtë aspekt. Situatë e ngjashme është edhe sa i përket mbikëqyrjes inspektive dhe raportimit mjedisor, ku përgjegjësia për raportet i është adresuar kryesisht AMMK-së.

Ndërkaq Drejtoria për Vlerësimin e Gjendjes së Mjedisit ka bërë të ditur se të dhënat për sistemet e monitorimit të mjedisit janë të publikuara në ueb faqen e AMMK-së. E, gjetjet kryesore të raportit për gjendjen e mjedisit 2020 të AMMK-së, të publikuar në fund të vitit 2021, ndër të tjerash bëjnë të ditur se Kosova vazhdon angazhimin e saj për harmonizimin e legjislacionit nacional me direktivat e BE-së, megjithëse sfida mbetet implementimi i tyre. Aty thuhet se ndonëse janë hartuar dhe aprovuar strategji dhe plane veprimi për të gjithë sektorët mjedisore, si në nivelin qendror dhe atë lokal, megjithatë niveli i zbatimit të tyre është i pjesshëm. Gjithashtu nënvizohet se gjatë vitit 2020 janë shtuar aktivitetet inspektuese dhe mbikëqyrëse në sektorin e mbrojtjes së natyrës, por se aktivitetet ilegale që degradojnë dhe dëmtojnë mjedisit janë ende në numër shqetësues. Ndonëse është rritur buxheti për projekte kapitale mjedisore, dhe gjithashtu është rritur edhe numri i projekteve nga donatorët, nevoja dhe kërkesa për investime në mjedis mbetet ende e lartë, dhe se çështja e mjedisit në Kosovë ende trajtohet me prioritet të ulët.

Edhe sistemet e menaxhimit të të dhënave mjedisore kërkojnë përmirësim të mëtejshëm ngase nuk janë të kompletuara, dhe njëkohësisht nevojitet staf adekuat.

Bashkëpunimi dhe koordinimi mes ministrive dhe institucioneve tjera publike në hartimin e akteve ligjore e nënligjore, si dhe strategjive mjedisore nga organet përgjegjëse është vlerësuar si i kënaqshëm, derisa pjesëmarrja e publikut në hartimin e dokumenteve mjedisore është vlerësuar si mesatar. Ngjashëm si në kapitujt tjerë, institucionet përgjegjëse duhet të shtojnë për raportim më efikas edhe sa i përket licencimit dhe lëshimit të lejeve mjedisore.

REKOMANDIME

- Çështja e mjedisit në Kosovë të trajtohet me prioritet të lartë;
- Të intensifikohen angazhimet sa i përket harmonizimit të legjislacionit me direktivat e BE-së;
- Të përmirësohet niveli i zbatimit të strategjive dhe planeve të veprimit në të gjithë sektorët mjedisorë;
- Të shtohen aktivitetet inspektuese dhe mbikëqyrëse për mbrojtjen e natyrës;
- Organet shtetërore përgjegjëse të sigurojnë mekanizma të qëndrueshëm të financimit për projektet mjedisore dhe mbrojtjen e mjedisit;
- Të ndërtohet një sistem i kompletuar i informimit mjedisor, ku hisedarët dhe publiku informohen në kohë reale sa i përket gjendjes mjedisore;
- Të shtohen përpjekjet për ndërgjegjësimin e qytetarëve për rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit;
- Të përmirësohet bashkëpunimi me shoqërinë civile;

FUND

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikëqyrjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme:

1. Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale,
2. Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe
3. Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 - 2024) ka këto elemente: 1. Gjithëpërfshirjen, 2. Qëndrueshmërinë, dhe 3. Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga poshtë lart.

Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

1. Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
2. Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyrë përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
3. Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura;
4. Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.